

S2 Albania sh.p.k

Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur

PËRMBAJTJA:

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E PERFORMANCËS	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	5
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	6 - 21

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Menaxhimin dhe ortakët e Shoqërisë S2 Albania sh.p.k.

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë **S2 Albania sh.p.k** (Shoqëria) të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2017, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 dhjetor 2017, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likujdijë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.


AUDITUESI LIGJIOR

Shoqëria AAP shpk

Dashnor Çarçani

Rr. Sami Frasheri, Pallati 19, Hyrja 8, Kati 6, Ap. 18, Tiranë.

26 qershor 2018



S2 Albania sh.p.k
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2017

	Shënime	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	9,827,809	19,308,873
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	128,646,201	127,041,097
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	6	133,908,274	-
Të tjera llogari të arkëtueshme	7	25,455,862	1,693,931
Shpenzime të shtyra	8	3,409,538	2,433,173
Aktive tatimore të shtyra	25	143,729,795	92,663,716
Total aktive afatshkurtra		444,977,479	243,140,790
Aktivet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	9	819,506,905	1,018,790,979
Të tjera llogari të arkëtueshme	10	6,465,994	3,200,459
Total aktive afatgjata		825,972,899	1,021,991,438
Total aktive		1,270,950,378	1,265,132,228
DETYRIMET			
Llogari të pagueshme tregtare	11	17,729,296	10,753,326
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	12	49,339,359	37,598,298
Të pagueshme për shpenzime të konstatuara	13	935,304,299	603,108,794
Detyrime tatimore	14	4,895,409	113,117,369
Provizione	15	2,463,758	2,463,758
Të tjera detyrime	16	7,244,339	4,353,790
Total detyrime afatshkurtra		1,016,976,460	771,395,335
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata		-	447,384,349
Të pagueshme për shpenzime të konstatuara	13	40,020,254	40,020,254
Total detyrime afatgjata		40,020,254	487,404,603
Totali i detyrimeve		1,056,996,714	1,258,799,938
KAPITALI			
Kapitali i nënshkruar	17	1,000	1,000
Fitime të mbartura		6,331,290	(132,746,285)
Fitimi i ushtrimit		207,621,374	139,077,575
Total kapitali		213,953,664	6,332,290
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		1,270,950,378	1,265,132,228

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

S2 Albania sh.p.k
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

	Shënim e	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	18	1,566,965,766	1,531,818,704
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	19	6,213,068	(1,447,044)
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme		(837,445,557)	(889,801,366)
1) Lënda e parë, materiale të konsumueshme	20	(734,040,255)	(591,412,171)
2) Të tjera shpenzime	21	(103,405,302)	(298,389,195)
Shpenzime te personelit	22	(183,085,555)	(142,353,639)
1) Paga dhe shpërblime		(164,473,233)	(127,060,242)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore		(18,612,322)	(15,293,397)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	9	(204,305,750)	(227,670,833)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	23	(7,466)	(123,061)
Të ardhura të tjera		-	-
Zhvlerësim i aktiveve financiare dhe investimeve të mbajtura si aktive afatshkurtra		(79,496,198)	(64,371,895)
Shpenzime financiare	24	(7,815,851)	(48,912,487)
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme		(7,815,851)	(48,912,487)
Fitimi/humbja para tatimit		261,022,457	157,138,379
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	25	(53,401,083)	(18,060,804)
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(104,467,162)	(110,724,520)
2) Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë		51,066,079	92,663,716
Fitimi/humbja e vitit		207,621,374	139,077,575
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		207,621,374	139,077,575

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

S2 Albania sh.p.k
 Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
 (Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
 Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

	Kapitali i nëshkruar	Fitimet e Pashpërndara	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni më 1 Janar 2016	1,000		(132,746,285)	(132,745,285)
Të ardhura totale gjithpërfshirëse për vitin:				
Fitimi / Humbja e vitit			139,077,575	139,077,575
Levizje përmes kapitalit		(132,746,285)	132,746,285	-
Pozicioni më 31 dhjetor 2016	1,000	(132,746,285)	139,077,575	6,332,290
Fitimi / Humbja e vitit			207,621,374	207,621,374
Levizje përmes kapitalit		139,077,575	(139,077,575)	-
Pozicioni më 31 dhjetor 2017	1,000	6,331,290	207,621,374	213,953,664

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 janë aprovuar nga administratori më 10.05.2018 dhe janë firmosur si më poshtë:

Jonathan Fleming
 Administrator



ILD-99 Audit shpk
 * Hartues Pasqyrave Financiare



S2 Albania sh.p.k
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	207,621,374	139,077,575
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet financiare jomonetare	70,226	755,597
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar	53,401,083	16,060,804
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	204,305,750	227,670,833
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(134,076,097)	(36,622,471)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	242,690,576	(611,948,846)
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	2,890,549	3,768,711
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	576,903,461	(261,237,797)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(5,021,676)	(39,411,756)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(5,021,676)	(39,411,756)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Hua të arkëtuara	-	261,846,492
Pagesa e huave	(581,292,623)	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	(581,292,623)	261,846,492
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	(9,410,838)	(38,803,061)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	19,308,873	58,867,531
Efeksi i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare	(70,226)	(755,597)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	4 9,827,809	19,308,873

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "S2 Albania" është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më datë 22.05.2013.

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është zbatimi i marrëveshjes së koncesionit në lidhje me skanimet e mallrave të importuara, automjeteve, kontenjerëve etj në pikat doganore Shqiptare si dhe cdo aktivitet tjetër lidhur me këtë ose i kërkuar për të realizuar zbatimin e marrëveshjes. Shoqëria ka të drejtën të kryejë cdo transaksion si veprimtari tregtare, financiare, qiradhënie, qiramarrje etj që mund të konsiderohet i dobishëm ose i nevojshëm për arritjen e objektit të lartpërmendur të shoqërisë.

Selia e shoqërisë është në adresën: Rruga dytesore Tirane-Durres, km 9, godina nr pasurie 83/7/3 zona kadastrale 2105.

Administrator i shoqërisë "S2 Albania" është Z.Jonathan Fleming.

Ajo është regjistruar në Drejtorinë e Tatimpaguesëve të Mëdhenj me NIPT L31722010Q.

Më 31 dhjetor 2017 Shoqëria kishte 97 punonjës (2016: 95 punonjës).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Në bazë të urdhrin nr.64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdher hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119 datë 1 gusht 2014.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

2. Bazat e pregatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1 Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga paaftësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çrregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2 Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit që mund të masë me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6 Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përvec rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

3 Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.1. Transaksionet në monedhë të huaj (vazhdim)**

vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2017	2016
Euro/ALL	132.95	135.23
USD/ ALL	111.10	128.17

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2 Instrumentat financiare (vazhdim)

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3 Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4 Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)***ii. Kostot e mëpasshme*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2017 dhe 2016 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Mobilje dhe orendi	Vlerë e mbetur	20 %
Pajisje informatike	Vlerë e mbetur	25 %
Instrumenta dhe vegla pune	Vlerë e mbetur	20 %
Mjete transporti	Vlerë e mbetur	20 %
Të tjera	Vlerë e mbetur	20 %

iv. Çregjistrimi

Një zëri i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5 Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6 Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7 Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.8 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9 Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2017 është 15% (2016: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

3.10 Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.13 Aktivët dhe Detyrimet e Kushtëzuara**

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë paraqiten si më poshtë më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Mjete monetare ne banke		
Banka në Leke	3,605,256	12,112,780
Banka në EUR	6,042,283	4,294,437
Banka në USD	58,814	2,718,848
Arka	121,456	182,808
Totali	9,827,809	19,308,873

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	128,646,201	127,041,097
Totali	128,646,201	127,041,097

6. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Hua për Rapiscan UK	133,908,274	-
Totali	133,908,274	-

7. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Shteti – TVSH për tu marrë	143,868,093	64,371,895
Zhvlerësim i kërkesave të arkëtueshme për TVSH	(143,868,093)	(64,371,895)
Te tjera të arkëtueshme nga Varian	-	1,693,931
Tatim Fitimi	25,455,862	-
Totali	25,455,862	1,693,931

Levizja e zhvleresimit gjate periudhes:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Çelja më 1 Janar	64,371,895	-
Zhvleresimi gjatë vitit	79,496,198	64,371,895
Gjendja 31 Dhjetor	143,868,093	64,371,895

Shoqëria ka zhvlerësuar kërkesat e arkëtueshme për TVSH-në sipas në politikave të saj të zhvleresimit të kërkesave të arkëtueshme të vjetra mbi 365 ditë.

8. Shpenzime të shtyra

Shpenzimet e shtyra më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Shpenzime për shërbime teknike	2,291,800	2,142,667
Shpenzime për përshtatje ambienti	1,097,604	-
Parapagime ndaj furnitorëve	20,134	19,682
Shpenzime për siguracione	-	270,824
Totali	3,409,538	2,433,173

9. Aktive afatgjata materiale

	Makineri Pajisje	Automjetet	Mobilje orendi	Pajisje kompjuterike	Instrumenta Pune	Totali
Kosto						
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	1,206,425,173	17,328,551	2,301,217	1,846,437	1,509,381	1,229,410,759
Shtesa	34,079,816		1,410,505	2,664,341	1,257,094	39,411,756
Gjendja më 31 Dhjetor 2016	1,240,504,989	17,328,551	3,711,722	4,510,778	2,766,475	1,268,822,515
Shtesa	-	-	3,530,917	930,271	560,488	5,021,676
Gjendja më 31 Dhjetor 2017	1,240,504,989	17,328,551	7,242,639	5,441,049	3,326,963	1,273,844,191
Amortizimi i akumuluar						
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	17,939,359	3,038,448	632,482	710,335	40,079	22,360,703
Amortizimi i vitit	223,138,288	2,858,021	454,905	770,562	449,057	227,670,833
Gjendja më 31 Dhjetor 2016	241,077,647	5,896,469	1,087,387	1,480,897	489,136	250,031,536
Amortizimi i vitit	199,885,468	2,286,416	784,614	858,596	490,656	204,305,750
Gjendja më 31 Dhjetor 2017	440,963,115	8,182,885	1,872,001	2,339,493	979,792	454,337,286
Vlera neto kontabël						
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	1,188,485,814	14,290,103	1,668,735	1,136,102	1,469,302	1,207,050,056
Gjendja më 31 Dhjetor 2016	999,427,342	11,432,082	2,624,335	3,029,881	2,277,339	1,018,790,979
Gjendja më 31 Dhjetor 2017	799,541,874	9,145,666	5,370,638	3,101,556	2,347,171	819,506,905

S2 Albania sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Vlerat janë në Lek)

10. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë e tjera të arkëtueshme për vitin që mbyllet më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Garanci bankare për kartën e kreditit	3,968,276	702,741
Garanci për qira	2,497,718	2,497,718
	<u>6,465,994</u>	<u>3,200,459</u>

11. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Furnitorë të huaj	16,216,848	8,922,355
Furnitorë vendas	1,512,448	1,830,971
	<u>17,729,296</u>	<u>10,753,326</u>

12. Të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Të pagueshmet ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Të pagueshme tregtare ndaj Rapiscan UK	14,962,318	10,204,105
Të pagueshme tregtare ndaj ICMS	34,377,041	27,394,193
	<u>49,339,359</u>	<u>37,598,298</u>

13. Të pagueshme për shpenzime të konstatuara

Të pagueshme për shpenzime të konstatuara për vitin që mbyllet më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2017</u>	<u>31 Dhjetor 2016</u>
Afatshkurta		
Të tjera shpenzime të përlogaritura	931,490,654	600,067,395
Shpenzime për fatura të pa mbëritura	3,813,645	3,041,399
Afatgjata		
Të tjera shpenzime të përlogaritura	40,020,254	40,020,254
	<u>975,324,553</u>	<u>643,129,048</u>

14. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	2,681,769	2,450,335
Tatimi mbi të ardhurat personale	1,801,166	1,643,165
Tatim në burim	412,474	299,349
Tatim mbi fitimin	-	108,724,520
	<u>4,895,409</u>	<u>113,117,369</u>

S2 Albania sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Vlerat janë në Lek)

15. Provizione për rreziqe

Provizionet afatshkurtra dhe afatgjata për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten në tabelen e mëposhtme:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Balanca në çelje	2,463,758	2,463,758
Provizioni i periudhës	-	-
Balanca në fund	<u>2,463,758</u>	<u>2,463,758</u>

16. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 përbëhen nga detyrimet për pagat e punonjësve dhe paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2017</u>	<u>31 Dhjetor 2016</u>
Pushime të përlogaritura	7,244,339	4,353,790
	<u>7,244,339</u>	<u>4,353,790</u>

17. Kapitali themeltar

Kapitali i shoqërisë "S2 Albania" sh.p.k është 1,000 lekë, i ndarë në 1,000 kuota me vlerë nominale 1 lek.

18. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit paraqiten si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Të ardhura nga shërbimi i skanimit	1,566,490,276	1,531,694,972
Të ardhura nga shërbime	475,490	123,732
	<u>1,566,965,766</u>	<u>1,531,818,704</u>

19. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe paraqiten si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Fitime nga kursi I këmbimit nga aktiviteti i shfrytëzimit	60,636,693	69,446,512
Humbje nga kursi I këmbimit nga aktiviteti i shfrytëzimit	(54,423,625)	(70,893,556)
	<u>6,213,068</u>	<u>(1,447,044)</u>

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së dhe Tatim Fitimit.

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Qarkullim i tatueshëm	1,566,965,766
Shuma e qarkullimit e korrektuar	1,566,965,766
Sipas Kontabilitetit	1,566,965,766
Diferenca	-
Fitim nga këmbimet valutore	60,636,693
Te ardhura nga interesat	790,051
Total të ardhura deklaruar në deklaratën e Tatim Fitimit	<u>1,628,392,510</u>

20. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave, lëndeve të para dhe shërbimeve të konsumuara që lidhen me veprimtarinë e shfrytëzimit. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme paraqitet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Shërbime nga të tretë	338,681,245	232,227,905
Shpenzime për shfrytëzim licenca teknike, Marka tregtare dhe Royalties	181,416,469	99,968,895
Shërbime manaxheriale	107,612,391	147,292,222
Mirëmbajtje dhe riparime pajisjet	62,328,899	59,282,041
Tarifa e konçensionit	31,329,806	30,632,480
Shpenzime për karburant makinat	4,476,789	4,643,491
Uniforma për punonjësit	2,901,490	3,119,155
Shpenzime trajnimi punonjësit	1,935,800	17,421,222
Qira makina	1,765,472	1,077,921
Shpenzime transporti	1,003,592	211,342
Materiale të konsumueshme	312,189	287,897
Shpenzime dosimetrimi dhe kalibrimi	276,113	279,200
Shërbime teknike	-	(5,031,600)
	<u>734,040,255</u>	<u>591,412,171</u>

(Vlerat janë në Lek)

21. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera paraqiten si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Konsulenca ekonomike dhe juridike etj	37,105,618	239,973,202
Shpenzime qeraje	20,840,275	21,193,500
Shpenzime udhëtimi dhe diëta	19,012,531	14,971,146
Siguracione	7,742,844	3,355,261
Energji elektrike,ujë	7,341,847	7,308,994
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	2,897,335	1,514,736
Mirembajtje dhe riparime	2,100,745	1,173,743
Kancelari	2,097,645	1,901,168
Materiale të konsumueshme	959,186	2,437,162
Taksa dhe kotroll teknik makinat	846,220	1,057,170
Taksa Lokale	805,938	1,323,253
Shpenzime marketingu dhe publiciteti	512,580	376,780
Komisione bankare	502,944	400,002
Shpenzime për pritje	457,151	1,350,992
Shpenzime rekrutimi	121,155	32,149
Shpenzime të tjera	60,238	19,937
Shpenzime administrative	1,050	-
	103,405,302	298,389,195

22. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit paraqiten si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016
Paga dhe shpërblime	161,582,687	122,706,437
Shpenzime të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore	18,612,322	15,293,397
Shpenzime të përllogaritura për punonjësit	2,890,546	4,353,805
	183,085,555	142,353,639

23. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjobat dhe penalitetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016
Gjoba dhe penalitete	7,466	123,061
	7,466	123,061

24. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit dhe rezultatin nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të shoqërise. Ky zë paraqitet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016
Shpenzime për interesa	8,605,902	48,912,487
Te ardhura nga interesat	(790,051)	-
	7,815,851	48,912,487

25. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Fitimi para tatimit	261,022,457	157,138,379
Shpenzime të panjohura të tjera (si më poshtë)	435,425,289	694,436,133
Shpenzime pritje dhe percjellje	175,986	880,155
Shpenzime udhëtimi	13,532,685	15,461,790
Penalitete, gjopa e dëmshpërblime	7,466	123,061
Shpenzime të përlllogaritura përkohësisht të pa njohura	337,549,981	613,404,300
Shërbime teknike në proces për shmangien e tatimit në burim	-	(5,031,600)
Zhvlerësim i kerkesave për arketim (TVSH)	79,496,198	64,371,895
Shpenzime të përlllogaritura për punonjësit	6,251,354	4,353,805
Rimarrje e shpenzimeve të përlllogaritura për punonjësit nga viti I kaluar	(3,360,808)	
Shpenzime të tjera	1,772,427	872,727
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	696,447,746	851,574,512
Humbje fiskale e mbartur nga vit 2013	-	(8,809,031)
Humbje fiskale e mbartur nga vit 2014	-	(104,602,013)
Fitimi Fiskal	696,447,746	738,163,468
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin 15%	104,467,162	110,724,520
Tatim fitimi i shtyrë	(51,066,079)	(92,663,716)
	207,621,374	139,077,575

(Vlerat janë në Lek)

25. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin (vazhdim)

Tatimi i shtyrë:

Paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Tatim fitimi i shtyrë për shpenzime të perlllogaritura përkohësisht të pa njohura	142,643,142	92,010,645
Tatim fitimi i shtyrë për shpenzime të perlllogaritura për punonjësit	1,086,653	653,071
Tatim i shtyrë e aktiv (detyrim)	143,729,795	92,663,716

Paraqitur në Pasqyrën e Performances Financiare

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Tatim fitimi i shtyrë për shpenzime të perlllogaritura përkohësisht të pa njohura	50,632,497	92,010,645
Tatim fitimi i shtyrë për shpenzime të perlllogaritura për punonjësit	433,582	653,071
Tatim i shtyrë e ardhur (shpenzim)	51,066,079	92,663,716

Rakordimi

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Balanca me 01 janar	92,663,716
Tatimi i shtyrë e ardhur (shpenzim) gjatë vitit	51,066,079
Balanca më 31 dhjetor	143,729,795
Llogaritja e Tatim fitimit të shtyrë për periudhën	
Shpenzime të perlllogaritura përkohësisht të pa njohura	337,549,981
Shpenzime të perlllogaritura për punonjësit	6,251,354
Rimarrje perlllogaritje nga viti I kaluar	(3,360,808)
Total	340,440,527
Tatim fitimi i shtyrë 15%	51,066,079

(Vlerat janë në Lek)

26. Transaksionet me palët e lidhura

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura		
Rapiscan UK	14,962,318	457,588,454
ICMS	34,377,041	27,394,193
	<u>49,339,359</u>	<u>484,982,647</u>
	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Të arkëtueshme nga palëve të lidhura		
Rapiscan UK	133,908,274	-
	<u>133,908,274</u>	<u>-</u>

Detajet e transaksioneve me palët e lidhura gjatë vitit të mbyllur me 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016</u>
Blerje		
ICMS	338,681,245	192,207,651
Rapiscan UK	31,655,365	8,513,664
OSI Corporate	2,722,587	1,989,791
	<u>373,059,197</u>	<u>202,711,106</u>
	<u>Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016</u>
Shitje		
Rapiscan USA	570,588	-
	<u>570,588</u>	<u>-</u>

Politika e vendosjes së çmimeve për transaksionet me palët e lidhura bëhet në bazë të kushteve të tregut.

27. Angazhime dhe pasiguri

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të kenë efekt negativ në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj.

Më 31 Dhjetor 2017, Shoqëria nuk ka angazhime kapitale të kontraktuara por ende të papaguara.

28. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit që kërkojnë rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.